




**KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL VII/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VII (shtatë) për vitin 2026 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 21.07.2026
Ora : 10:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

z. Flamur Bytyqi
z. Enver Shabani
znj. Mimoza Bajraktari
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Laureta Tafaj
z. Dardan Berisha

Të pranishëm tjerë:

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Zyra për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private;**
- 3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-9877;**
- 4.Shqyrtimi i projekt-vendimit paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 5.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit monitruar i zbatimit PZHK-së dhe Hartës Zonale të Komunës së Suharekës;**
- 6.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2025,të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Eko-Theranda” SH.A**
- 7.Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-qershor 2026;**
- 8.Informatë për aktivitetet e KKSB-së për periudhën Janar-Qershor 2026;**
- 9.Raporti i Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër për menaxhimin e pronave për periudhën janar-qershor 2026;**

Kryesuesi-i njofton dhe për një pikë shtesë e cila është rishqyrtimi i vendimit 01-Nr-020-24518 për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale dhe e hedhë në votim rendin e ditës me pikën shtesë

Unanimisht miratohet rendi ditës

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Sanie Kuçi Rexhepaj-përshendetje për të gjithë,këtë lëndë ne e kemi shqyrtu edhe në mandatin e kalum,kështu që pak më na informu në procedura ku ka mbetë atëherë,e qka po bëjm konkretisht tash,a e kemi shpall atëherë interes të përgjithshëm e tash në të njëjten kohë veq këmbimin apo cila është saktësisht kjo procedur,përshkak se kjo pjesa përpara ka qenë pronë publike dhe atëherë pata thënë cilat kanë me qenë hapat e komunës për me pastru këtë bllok ndërtimor në mënyrë që me ju mundësu leja ndërtimit,ndërrhyrje të pronave private ka pas edhe lart në këtë bllok ndërtimor kështu që një sqarim pak më të qartë me na dhënë nëse ka mundësi.

Mensur Selimaj-përshendetje për të gjithë,përshkak të procedurave që kanë qenë në vlerësim në Ministri të Financave ka marrë kohë përshkak të ndryshimeve që kanë kërku.

Avni Bytyçi-përshendetje për të gjithë,vendimi është shpall në 2025 për interes të përgjithshëm përshkak të shpalljeve të zgjedhjeve nga Presidentja të gjitha procedurat janë pezulluar deri në konstituimin e organeve të reja,në momentin kur është bërë konstituimi i organeve të reja kanë fillu procedurat për kompletimin e landës dhe është dërgu kërkesa në Ministri për vlerësim të pronës dhe është kthyer vlerësimi ne kemi fillu me procedurat tjera.

Sanie Kuçi Rexhepaj-dhe një shqetësim tjetër që është ndërrhyrja më duket edhe e një parcele tjetër të rrugës në këtë bllok ndërtimor,ky trekëndëshi në skicë tregon që parcelat tjetër,për atë a ka zgjidhje apo nuk ka,a ka problematik Drejtoria Urbanizmit për me dhënë leje ndërtimore kur zgjidhet ky këmbim 55 me 55,ndërrhyrja e trekëndshit tjetër a i shkakton problematik Drejtorisë Urbanizmit për me dhënë leje ndërtimore.

Visar Kuçi-përshendetje për të gjithë,te kjo parcela dy herë ka pas rast për këmbim të pronës,rasti par është përfunduar,rasti dytë ka shkuar pak gjatë përshkak të zgjedhjeve,te pjesa ku po thua ti Sanie te pjesa e përparme është pjesë e parcelës e Brigadës 123 është e Ministrisë dhe ne nuk kemi të drejtë me ndërhyrë në këmbim vetëm kemi të drejtë me bërë zgjerimin e infrastrukturës edhe me hartë zonale.

Flamur Bytyçi- në këtë vendim që është marrë herën e kalume me dt 08.05.2025 është kan pjesë e dokumentacionit zotimi për ndarjen e mjeteve për me u bërë shpronësimi,a janë zotuar mjetet për këtë këmbim për vitin 2026?

Mensur Selimaj- pronë me pronë është këmbimi.

Avni Bytyçi-për me u bërë këmbimi i pronës publike paraprakisht duhet të plotësohen 10 kriterë,njëri nga kriterët është shpallja e interesit të përgjithshëm gjë që e kemi bërë dhe kërkojmë dokumenta tjerë shtesë dhe lëshohet njëri prej dokumentave a ka mjete apo nuk ka për me realizu projektin,dhe po besoj që Komuna ka mjete të mjaftueshme për me rregullu këtë rrugë.

Laureta Tafaj-përshendetje për të gjithë,këtu që e kemi një diferencë të vlerës së m²,prona e znj.Sevdije Berisha 55m² janë vlerësuar me 120m²,vlera totale është 13.750€ tash qysh ka me i ra,a ka me i kthyer zonja te na parat apo qysh se këtu duhet me qenë barazim,tjetra nëse nuk jemi gabim po folim për këto vendime me dt 29.10.2024 është shpallur interes i përgjithshëm për 55m²,mandej me 28.03.2025 për të njëjtin qëllim rruga Luigj Nikolla interesi publik u shpall për 122m²,këtu është një fotografi që unë nuk jam tu e kuptu qka keni bërë,sipas destinimit të hartave zonale,parcela e Komunës 1211/1 ka destinim banim me shumë njësi banesore për afarizëm edhe pjesërisht infrastrukturë rrugore dhe pompë e benzinës në Z4 por tash ka destinim me shumë njësi dhe afarizëm por është një kalë e kësaj pompe benzinës,që i bjen në Komunë është ndërtu diqka dhe ju e keni hekur për me i dhënë më shumë m²,dhe një çështje e kontestit gjyqësor Avokati i Komunës ka thenë që parcela e Komunës nuk ka kontekst gjyqësor ama ai ka deklaruar qart se nuk ka njohuri nëse

parcela private ka kontest eventual pasi që zyra e tij nuk mban evidencë, a jemi të sigurt që nuk ka me na dal dikush tjetër me na blloku punën që është në kontest gjyqësor, jam pro rregullimit të rrugës por jo në këto forma nëse nuk specifikohen secila veç e veç.

Visar Kuçi-fillimisht investitorët kanë kërkuar këmbimin e pronës, ky këmbim është bërë në dy pjesë, një pjesë ku po thu të parcela ndërtimore ka ZK4 dhe është pjesë ku lejohet hoteleri dhe pjesa tjetër brenda parcelës i ka disa destinime ajo pjesa përparme ka përfunduar, pjesa anësore është që ka destinim banim nuk ka të bëjë me të parën, kurse këmbimi kësaj është anësorja.

Mensur Selimaj-në moment që prona nuk ka ndalesë në kadastër ose një barrë në nuk e cilsojmë që ka kontest gjyqësor. Vlerat e tjera në veç i rekomandojmë dhe Ministria e ka vlerën e secilës pronë.

Avni Bytyçi-nëse i referohemi projekt vendimit vlera totale që Komuna jep është 139m² që i jep zonjës Sevdije Berisha dhe që i merrë është 177m², në fakt Komuna këtu fiton 38 m² dhe mbasi të bëhet ky vendim i plotëfuqishëm dhe konfirmohet nga Ministria në kemi obligim me nënshkruar Kontratë me znj dhe nëse ka mjete Komuna ja kompenzon vlerën për të cilën është më shumë prona private ose arrin ndonjë marrëveshje.

Kryesuesi- e hedhë në votim

6 për, 1 kundër miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-9877;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Sanie Kuçi Rexhepaj-mu duk një far dallimi prej këtij projekt-vendimi ndaj krejt vendimeve tjera të ngjajshme që i kemi marrë për inicim të procedurave pse po përmendet fjala paraprak, miratohet vendimi paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur kjo më duket me ndryshe prej krejt procedurave tjera që janë inicuar për konkurim të hapur.

Avni Bytyçi-prej vitit 2019 deri para 2 muaj e kemi përdorur varsisht prej njerëzve qysh e interpretojnë dhe nëse kemi bërë jepet pëlqimi për të zhvilluar procedurat Ministria me ka ftuar dhe ka kërkuar nga unë të referohemi ligjit sakt ligji thotë miratohet vendimi paraprak për të zhvilluar procedurat dhe unë ju kam referuar ligjit.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit monitorues i zbatimit PZHK-së dhe Hartës Zonale të Komunës së Suharekës;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Flamur Bytyçi-ky raport është dashtë me ardhë në kohë,unë mundemi me ju kuptu kur ka ngarkesa dhe punë të tjera por 2023-2026 është kogja kohë dhe po besojë nuk ka arsyetim me than kemi pas ngarkesë u bë mirë që u ardh përshkak se ky raport qel shumë rrug të reja për Suharekën.

Sanie Kuçi Rexhepaj-vonesa nuk arsyetohet në asnjë formë sepse arsyetimet brenda raportit që shënohen Drejtoria ka pas munges stafit dhe ngarkesa të tjera ato nuk jan arsyetime që qëndrojnë,qëndrojnë nëse është fjala për 6 muaj ose 1 vit por jo për 4 vite me radh,mungesa te raporti ka sjellë pengesa në inicim të rregulloreve të tjera dhe është munges e transparencës para llogaridhënjes në Kuvend,një raport i till mir që ka ardh por un nuk po e shoh raportin e PZHK-së HZK dhe PZHK jan dy dokumente plotësisht të ndara,plani zhvillimor Komunal është miratu në Tetor të vitit 2021 dhe raporti është desht me u bë edhe për vitin 2022,2023,2024 edhe për 2025 që jan katër vite të PZHK-së që nuk jan raportu,dhe raporti në total sqaron vetëm zbatimin e HZK-së jo të PZHK-së,për deri sa jan dy dokumente të ndara pamarrë parsysh Komisioni a është i njejtë apo jo duhet me u përgadit dy raporte të ndara,edhe projekt vendimi që përgadit Avniu duhet me qenë të ndara veqmas HZK veqmas PZHK-së pasi që koha e raportimit nuk është e njejta.E kisha sugjeru Drejtorin me i nda këto dy raporte,raportin që e kan sjellë është i përmbledhur mirpo ka edhe mangësi dhe ka shumë fjal përseritëse,raporti duhet me qenë raportues e jo tregues final ky është sugjerimi im dhe besoj që edhe Ministria njëjt ka me kërku sepse jan dokumente të ndara.

Visar Kuçi-në udhëzimin administrativ te PZHK-së ku e ka lexu ekipi një paragraf thot duhet të formohet ekipi për monitorimin e PZHK-së diqka më teper nuk thuhet,kurse te Harta zonale është më e specifikune dhe te HZK e kemi edhe shtojcën e monitorimit dhe këto tabela jan bartë që jan edhe te plani zhvillimor.PZHK ne skemi mujt me zbatu përshkak se kemi pas të ndalume me vendim të Ministrisë deri në hartimin e hartës zonale.

Sanie Kuçi Rexhepaj-për derisa thot që duhet me u formu ekipi,duhet me raportu PZHK dhe është obligim ligjor edhe në Kuvend edhe në Ministri,tek pjesa 2022 që nuk keni raportu unë edhe në Kuvend kam thën se të njejtin e arsyetim jemi konsultim me Minisitrin,në dialog duhet me marr përbaz në Kuvend përshkak se ti thu vazhdimisht konsult me Ministrin dhe pastaj po kthehen vendimet,të kam thën edhe në Kuvend sdi sa e mban mend edhe nëse PZHK nuk është tu u zbatu për qfardo arsye sjelle raportin dhe nuk kemi zbatu kurgjo nga PZHK për këtë arsye dhe ai është raporti,nuk dmth që veq nëse e kryen një punë duhet me raportu edhe punën e pa kryer duhet me raportu,kështu që raporti 2022 është tut mungu për PZHK-në.

Flamur Bytyçi-paska punu një ekip kogja i madh po e vrej që dy nënshkrime po mungojnë të Drejtoreshës për kultur dhe sport dhe i Drejtoreshës së Shëndetësis apo i bjen që nuk jan pajtu me këtë raport.

Visar Kuçi-ate ditë kur është përcjellë raporti për KPF ka mungu anëtari i Drejtorisë së Kulturës dhe i Shëndetësis dhe ne e kemi përcjellë te ju për mos me humb kohë dhe sot janë të nënshkrime dhe ja u dorzojmë me material të Asamblesë.

Laureta Tafaj-sa i përket kësaj pike unë i kam disa rekomandime nëse i pranon Drejtori se ne jemi këshilltar Komunal dhe kemi të drejtë,Drejtor rekomandimet e mia për KPF dhe në Asamble janë :Garantimi i raportimit periodik ligjor këte e permenden edhe kolegët,rishikimi i dokumenteve të planifikimt,duke qenë që raporti konstaton se zhvillimet e reja ekonomike kan nevoj për rishikim atëher për me ju përshtat nevojave reale të bizneseve dhe qytetarëve kërkoj që me bë ndonjë ndëgjim publik,dhe zgjedhja e konflikteve mes banorëve të fshatit Mushtisht dhe

Baqevc,dhe prioritetizimi i impiantit në Nëpërbisht dhe rritja e transparencës digjitale jan rekiomandimet e mia sa i përket kësaj pike.

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2025,të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Eko-Theranda” SH.A

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika7. Rishqyrtimi i vendimit 01-Nr-020-24518 për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale

Kryesuesi-e elaboron dhe e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 8. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-qershor 2026;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe pasi nuk ka debat e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 9. Informatë për aktivitetet e KKSBB-së për periudhën Janar-Qershor 2026;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj-po besoj që jeni të informuar për rastin në Greikoc,dhe po thuajse na u ka bërë rutin dhe më nuk po na vjen interesant,dhe unë po e di që nuk është faj personal i kërkujt por me gjet një zgjidhje së bashku.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 10. Raporti i Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër për menaxhimin e pronave për periudhën janar-qershor 2026;

Kryesuesi- e elaboron dhe pasi nuk ka debat e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Takimi përfundoi- 11:00